



DETYRA PROJEKTUESE PËR HARTIMIN E PROJEKTIT URBO-ARKITEKTONIK
“SHESHI I PAVARËSISË - PRESIDENT IBRAHIM RUGOVA”

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe e Mbrojtjes së Mjedisit ka përpiluar detyrën projektuese për hartimin e Projektit urbo-arkitektonik “Sheshi i Pavarësisë”

I. LOKACIONI

Sheshi i Pavarësisë është në pjesën qendrore të qytetit. Në pjesën veriore tregon me Kuvendin e Kosovës, në pjesën lindore me rrugën unazore-unaza qendrore e qytetit, e cila sheshin e ndan nga lagjja “Dodona”, në pjesën jugore me hotelin “Iliria”, kurse në anën perëndimore me objektin e Shërbimeve Publike dhe objektin e Qeverisë së Kosovës.

Në kuadër të “Sheshit të Pavarësisë” hyjnë: objekti i Teatrit Kombëtar, objekti ish- Unioni, dhe sheshi “Skënderbeu”.

Ky lokacion përfshin një sipërfaqe prej 1.30 ha dhe do të jetë pjesë integruese e bulevardit “Nënë Tereza”.

II. QËLLIMI

Sigurimi i infrastrukturës fizike dhe institucionale në funksion të krijimit të ambientit të qëndrueshëm urban sipas PSZHU-së, Planit rregullues “Qendra 1” dhe në harmoni me kërkesat aktuale - vendosja e kornizës së planifikimit dhe rregullimit urban, hapat më tej për veprim, afati kohor dhe monitorimi.

Hapësirat e lira, lëvizja e qytetarëve dhe ndërlidhja me rrugën - unaza “Qendra”, janë elemente që krijojnë bërthamën e qytetit dhe ndikojnë në zhvillimin e aktiviteteve shumëfunktionale në qytet.

III. OBJEKTIVI :

- Shprehje e identitetit të qytetit përmes vlerave kulturo-historike - gërshetim i së kaluarës dhe së ardhmes - vendosje e bazamentit për të ardhmen;
- Mundësi për qasje të drejtë dhe të njëjtë edhe në zonat tjera urbanistike të qytetit;
- Ngritje e nivelit të jetës urbane për banorët e qytetit dhe të tjerët që vijnë nga rrethina;
- Shfrytëzim dhe rregullim racional i hapësirave të lira;
- Krijim i ambientit të qëndrueshëm urban.

Në funksion të zhvillimit të hapësirave të lira dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve. Ndërlidhja me rrugën unazore - unaza qendrore e qytetit, paraqet element që krijon bërthamën e qytetit dhe ndikon në zhvillimin e aktiviteteve shumëfunktionale në qytet.

IV. PËRPARËSITË DHE MUNDËSITË:

- Lokacioni është i koncentruar në zonën, e cila përfshihet në kuadër të PSZHUP-së dhe PRR "Qendra 1", përkatësisht integron hapësirat e lira të kësaj zone qendrore. Në këtë hapësirë do të zhvillohen aktivitetet kryesore të bërthamës së qytetit dhe duke krijuar kushte për harmonizim të funksioneve në hapësirën e gjerë urbane, si dhe ndërlidhjen me zonat përreth.
- Kycje e lehtë në objektet e infrastrukturës publike.
- Kushtet ekzistuese krijojnë mundësi për rregullim – rigjenerim të hapësirave të lira në qendër të qytetit-lokacionit në fjalë.
- Ekzistimi i rrugëve kryesore në gjendje të volitshme dhe funksionale, në të cilat zhvillohet trafik funksional - ku furnizimet dhe qasja në hapësirat nëntokësore të sheshit nuk parashohin nevojë të domosdoshme të trafikut, (marrë parasysh idetë apo nevojat lokale për mundësi trafiku).
- Ambienti i krijuar rezulton një gjendje faktike, e cila shfrytëzohet si shëtitore dhe koncentrim i qytetarëve – "ambient për të gjithë".
- Aktivitete shumëfunktionale në shërbim të kategorive të ndryshme të qytetarëve.
- Identitet i qytetit dhe mundësi për qasje të drejtë dhe të njëjtë edhe në zonat tjera urbanistike të qytetit – ngritje e nivelit të jetës urbane për qytetarët dhe të tjerët që vijnë nga rrethina.
- Ulje e ndikimeve negative në ambient-(automjetet, siguria), që krijojnë kushte për gjallërim të jetës dhe të aktiviteteve kryesore.
- Çështja pronësore e definuar – pasi që prona është kryesisht nën administrim të KK-së së Prishtinës.

V. KONCEPTI BAZË

- Sheshi i Pavarësisë - rigjenerim i hapësirave publike në funksion të formimit të krijimit të sipërfaqeve të lira në brendi të qytetit, që ndërlidh bërthamën e zonës me pjesët tjera të qytetit, duke krijuar arterien kryesore të peizazhit të qytetit në harmoni me hapësirat përreth.
- Hapësira destinohet sipas PSZHUP-së, si në funksion të sheshit të qytetit, implementimi i të cilit duhet të rezultojë në zhvillimin e një ambienti të qëndrueshëm urban, si "ambient për të gjithë".
- Pikënisja e implementimit të programit "Rrjeti i gjelbër" i qytetit, që krijon kushte bazë për një standard më të lartë të jetës për qytetarët.

- Definimi i hapësirës rekreative, komunikuese dhe gjelbëruese, duke pasur parasysh treguesit urban dhe imazhin që mund ta ketë.
- Zonat gjelbëruese – si pjesë përbërëse e “Sheshit të Pavarësisë”; definimi i tyre duke shprehur raport të harmonizuar me pjesën tjetër të trajtuar të sheshit.
- Hapësirën komunikuese/qarkulluese, që integron bulevardin “Nënë Tereza”, si arterien dominuese të qytetit, që shpreh drejtimin bosht dhe shtigjet e integruara dytësore; simbolikën e linjave urb-arkitektonike, trendet bashkëkohore në arkitekturë në funksion të krijimit të simbolikës dhe identitetit të “Sheshit të Pavarësisë”.
- Elementet përcjellëse që shprehin atraksion për zonën, si: ulëset, hapësirat ujore, hapësirat për manifestime publike, shtigjet, trajtimi/fasadimi i objekteve dhe modelimi, si elemente simbol dhe harmoni (psh. panotë reklamuese të jenë pjesë e hapësirave dhe funksionimi i aktiviteteve afariste në shërbim të sheshit).
- Element i rëndësishëm dhe i veçantë i sheshit – vendosja e monumentit të Pavarësisë. Monumenti të jetë i bazuar në simbolikë, formë, pozitë dhe lartësi në funksion të shprehjes së vlerave kulturo-historike, si sintezë që gërsheton të kaluarën dhe vendos bazament për të ardhmen.
- Infrastruktura publike – objektet e infrastrukturës si: ndriçimi publik dhe elementet tjera në funksion të sheshit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr.35-1024, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa